


KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSHTINA LIPJAN

Pranuar më: 09.10 2020		
Punjuene:		
Mesta Jednica	Numri Birel	Shtesa Dedetak
1-400-49507		



WOMEN 4 WOMEN
KOSOVO

Memorandum Mirëkuptimi në mes Kosova - Women4 Women dhe Komuna e Lipjanit

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejme i referuar si 'Memorandumi') ka për synim krijimin e partneritetit mes Kosova -Women 4 Women (në vazhdim i referuar si 'KW4W') dhe Komunës së Lipjanit (në vazhdim i referuar si 'Komuna').

Ky dokument nuk paraqet Marrëveshje që i lidh palët ligjërisht në implementim të aktiviteteve të ndryshme për synime të përbashkëta, mirëpo i elaboron kushtet në bazë të të cilave do të funksionojë ky bashkëpunim si dhe rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë.

I. Objektivat e bashkëpunimit

Qëllimi i Memorandumit është që të ofrojë kornizën e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes palëve me qëllim të fuqizimit ekonomik dhe social të grave të kësaj komune dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në procese të ndryshme vendimmarrëse dhe afariste.

II. Rolet dhe përgjegjësitë

Duke e nënshkruar këtë memorandum, palët pajtohen t'i përmbushin rolet dhe përgjegjësitë në vazhdim:

- a. KW4W do të ketë përgjegjësi:
 - Të bëjë mobilizimin e grave dhe burrave për pjesëmarrje në aktivitete dhe programe,
 - Të bëjë organizimin e trajnimeve,
 - Ti koordinojë aktivitetet me zyrtarë/et komunal,
 - Të gjitha obligimet financiare dhe obligimet tjera i bartë KW4W,

b. Komuna do të ketë përgjegjësi:

- Të emërojë një zyrtar/e si person kontaktues për koordinim të aktiviteteve,
- Të bashkëpunojë në mobilizimin e grave për pjesëmarrje në aktivitete dhe programe,
- Aty ku është e mundur të ofrojë hapësira për nevoja të aktiviteteve dhe projekteve,
- Komuna e Lipjanit nuk ka asnjë obligim financiar në këtë memorandum.

III. Konfidencialiteti

Të dyja palët pajtohen që të dhënat dhe informatat që merren/grumbullohen përgjatë këtij bashkëpunimi do të trajtohen me konfidencialitet dhe sipas ligjeve të Kosovës. Edhe pas përfundimit të projektit informatat personale të rasteve mund të përdoren vetëm me miratimin me shkrim të tyre.

IV. Kohëzgjatja e Memorandumit të Mirëkuptimit

Ky Memorandum hyn në fuqi me datën e nënshkrimit dhe do të mbesë në fuqi deri në rastin e modifikimit apo përfundimit të projektit me 30 tetor 2021, me mundësi vazhdimi. Në rast se ndonjëra palë dëshiron ta ndërpresë marrëveshjen para datës së cekur më lartë, palët obligohen të bëjnë njoftim me shkrim 1 muaj përpara se marrëveshja të konsiderohet e ndërprerë.

V. Autorizimi

Duke e nënshkruar këtë memorandum, të dyja palët pajtohen që t'i përmbushin termet e saj në mirëbesim. Edhe pse kjo marrëveshje nuk është obligative ligjrisht për ta implementuar, ajo është dëshmi e përkushtimit për t'i zbatuar rolet dhe përgjegjësitë e paracaktuara në këtë marrëveshje.

Kosova - Women 4 Women

Emri: Iliriana Gashi

Titulli: Drejtore

Adresa: Arbëria III, Rruga Kosturi, nr. 69

10000 Prishtina

Data: 08.10.2020



Komuna e Lipjanit

Emri: Imri Ahmeti

Titulli: Kryetar i Komunes

Adresa: Rr. Shqipëria, nr. 28

14000 Lipjan

Data: 08.10.2020

